



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHKOLLA E MAGJISTRATURËS
KËSHILLI DREJTUES

Nr. 1537/prot.
7

Tiranë, më 17.12 2025

V E N D I M

Nr. 39, datë 17.12.2025

**PËR
DISA NDRYSHIME NË PLANIN MËSIMOR TË VITIT TË DYTË TË KANDIDATËVE
PËR MAGJISTRATË PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**

Në mbështetje të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, i mbledhur më datë 17.12.2025.

V E N D O S I:

I. Të bëhen këto ndryshime në Planin Mësimor të vitit të dytë 2025-2026 të Shkollës së Magjistraturës, të miratuar me vendimin nr. 29, datë 30.9.2025, "Për miratimin e planeve mësimore në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2025-2026", si më poshtë:

1. Pika 6, Mënyra e vlerësimit të vitit të dytë, ndryshon si vijon:

6. Mënyra e vlerësimit të vitit të dytë

Praktika paraprofesionale vlerësohet nga një skemë gjithëpërfshirëse që përbëhet nga disa komponentë vlerësimi dhe procesi i vlerësimit përfshin një ekip të kombinuar me përfaqësues nga Shkolla dhe me përfaqësues nga gjykatat dhe prokuroritë ku zhvillohet praktika paraprofesionale vëzhguese. Në ekipin vlerësues përfshihen:

- Vlerësimi i përbashkët i pedagogëve për dosjen e kandidatit të realizuar në periudhën e praktikës paraprofesionale.

2. Mënyra e vlerësimit të praktikës në gjykata dhe prokurori, pika 2.2 *Vlerësimi përmes dosjes, "portofolit", të kandidatit (akteve dhe memove)*, ndryshon si vijon:

"1. Vlerësimi i dosjes së kandidatit do të jetë me 100 pikë, me koeficient vështirësie 2.15 dhe do të bëhet nga pedagogët e brendshëm përgjegjës, si dhe nga pedagogët e lëndëve përkatëse (Tabela bashkangjitur.)

2. Ky vlerësim do të realizohet nga Komisioni i Vlerësimit i ngritur me urdhër të Drejtorit. Komisioni përbëhet nga, të paktën, dy pedagogë.

3. Lidhur me vizitën studimore

Te pika 2, shkronja "a", fjalia e fundit ndryshohet si më poshtë:

- Praktikë dhe/ose vizitë studimore në **institucione ndërkombëtare, gjykata ndërkombëtare dhe shkolla homologe.**"

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.